



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

# 2022-2023

## RAPORT MONITORIMI

ZBATIMI I LIGJIT NR.60/2016  
“PËR SINJALIZIMIN DHE  
MBROJTJEN E SINJALIZUESVE NË  
9 BASHKI TË VENDIT”



ME MBËSHTETJEN:



Ky raport është përgatitur në kuadër të nismës “*Jo Korrupsionit, Po Demokracisë*”, i cili zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e Ambasadës Suedeze.

Përgatiti Raportin Studimor:

***Znj. Nadia Rusi , Eksperte e jashtme Ligjore***

Kontribuan në rishikimin dhe redaktimin:

***Z. Njazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH***

***Znj. Ardita Kolmarku, Drejtuese e Klinikës së Ligjit/Menaxhere Projektesh, KShH***

***Znj. Teuta Pataj, Asistente Projektesh/Paraligjore, KShH***

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

**Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

**Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania**

**Kutia Postare nr.1752; Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;**

**E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al) ; Web site: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)**

<b>Tabela e Përmbajtjes</b>	
<b>SHKURTIME:</b> .....	<b>2</b>
<b>Përmbledhje Ekzekutive</b> .....	<b>3</b>
<b>1.1 Konteksti, qëllimi dhe kufizimet e monitorimit</b> .....	<b>5</b>
<b>2. Analiza e gjetjeve të monitorimit të zbatimit të ligjit mbi sinjalizimin në nivel vendor ....</b>	<b>7</b>
<b>2.1 Përbërja dhe kapacitetet profesionale të Njesisë Përgjegjëse pranë Bashkive</b> .....	<b>7</b>
<b>2.2 Aksesueshmëria e Njësive Përgjegjëse pranë Bashkive dhe kanalet e sinjalizimit</b> .....	<b>11</b>
<b>2.4 Procedura e hetimit të rasteve të sinjalizimit dhe mbrojtja e të drejtave të sinjalizuesve</b> .....	<b>12</b>
<b>2.5 Ruajtja e konfidencialitetit të sinjalizuesve</b> .....	<b>14</b>
<b>2.6 Mungesa e rasteve të sinjalizimit dhe sfidat e Njësive Përgjegjëse</b> .....	<b>15</b>
<b>2.7 Marrëdhënia e Njësive Përgjegjëse me ILDKPKI-në</b> .....	<b>15</b>
<b>2.8 Informimi i punonjësve mbi kuadrin ligjon për sinjalizimin</b> .....	<b>16</b>
<b>2.9 Roli i ILDKPKI-së lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjit për sinjalizimin</b> .....	<b>16</b>
<b>3. Rekomandime</b> .....	<b>19</b>
<b>3.1 Rekomandime për Autoritetet Kompetente në Bashki</b> .....	<b>19</b>
<b>3.2 Rekomandime për Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit</b> .....	<b>20</b>
<b>3.3. Rekomandime lidhur me ndryshime ligjore dhe nënligjore të nevojshme (adresuar Parlamentit dhe Këshillit të Ministrave):</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Bibliografia:</b> .....	<b>20</b>

SHKURTIME:

KSHH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
NjP	Njësi Përgjegjëse
NjVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
SNK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit

## Përmbledhje Ekzekutive

Në kuadër të zbatimit të iniciativës “Jo Korrupsionit, Po Demokracisë”, të mbështetur financiarisht nga Qeveria Suedeze, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) monitoroi nivelin e zbatimit të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” (i ndryshuar) dhe planet e marra për adresimin e rekomandimeve të lëna më herët ndaj 9 Bashkive të vendit. Bashkitë me të cilat u bashkëpunua përgjatë këtij procesi ishin Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kukës, Gjirokastrë, Elbasan dhe Korçë.<sup>1</sup>

Krahas vënies në pah të praktikave dhe eksperiencave pozitive, vështirësitë dhe sfidat e adresuara nga ana e punonjësve të Njësisë Përgjegjëse të ngritura pranë organeve të vetëqeverisjes vendore, vlerësojmë se i shërbejnë pozitivisht rritjes së efikasitetit dhe proaktivitetit që duhet të tregohet nga ana e institucioneve përgjegjëse për të garantuar mbrojtjen e sinjalizuesve.

Në kontekstin metodologjik, ky raport u hartua mbështetur në analizën e detajuar të kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi sinjalizimin, si dhe të dhënat e grumbulluara në terren nëpërmjet bashkëbisedimit me përfaqësuesit e NjP sipas pyetësorëve të dedikuar.

KShH evidentoi se formalisht, në përputhje me ligjin nr. 60/2016 (i ndryshuar), në të gjitha bashkitë objekt monitorimi janë ngritur NjP. Megjithatë, vijon të mbetet e paqartë dhe konfuzë situata me detyrimin për ngritjen e NjP në nivel të institucioneve të varësisë të Bashkisë, duke përfshirë një panoramë jo të unifikuar. E njëjtë paraqitet situata edhe lidhur me përbërjen e numrit të anëtarëve të NjP, ku në Bashkitë Tiranë dhe Kukës rezulton se ushtrojnë funksionin 3 anëtarë, ndryshe nga shumica e Bashkive të cilët e kanë ngritur njësinë vetëm me 2 anëtarë. Vijon të konstatohet jo e adresuar ngarkesa që përballojnë punonjësit e NjP, të cilët paralelisht ushtrojnë detyrën funksionale si punonjës pranë Drejtorisë së Auditimit apo Burimeve Njerëzore. Angazhimi ekstra i tyre si punonjës të NjP vijon të mos jetë i përfshirë në termat e referencës së pozicionit të punës pranë Bashkisë, ndërkohë që ky funksion nuk konsiderohet gjatë vlerësimit vjetor të performancës në punë, e as të sjellë ndikim financiar shtesë.

Reformat në administratën publike, të cilave në mënyrë të vazhdueshme i janë nënshtruar edhe organet e njësisë të qeverisjes vendore, nuk kanë garantuar qëndrueshmërinë e kënaqshme të stafit përgjegjës. Si rrjedhojë, cikle të vazhdueshme zëvendësimi të anëtarëve vërehen në një pjesë të Bashkive të monitoruara. Ky proces i ndikuar nga një sërë faktorësh, në vlerësimin e KShH-së duhet të shoqërohet me trajnimin periodik dhe të vazhdueshëm nga ana e ILDKPKI-së të anëtarëve të NjP. Procesi i fundit trajnues i përket vitit 2021 dhe është ndërmarrë nga KShH në bashkëpunim me ILDKPKI-në. Partneriteti luajal ndërmjet NjP dhe ILDKPKI-së në këto raste është tepër i rëndësishëm, me synim komunikimin në kohë dhe objektiv të ILDKPKI-së për zëvendësimet e realizuara dhe procesin suportues që kërkohet nga Inspektorati në cilësinë e organit kompetent përgjegjës në nivel epror për zbatimin e këtij ligji. Duke konsideruar nevojën imediate është e

<sup>1</sup> [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/03/3.3.21\\_Final\\_KORRUPSIONI2021\\_shqip.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/03/3.3.21_Final_KORRUPSIONI2021_shqip.pdf)

vlerësueshme që në fushata sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere të përfshihen edhe punonjësit e tjerë të Bashkisë, ndërkohë që në median sociale ose faqen elektronike të institucionit mund të publikohen materiale ndërgjegjësuere e informuese.

Ky proces monitorimi nxori në pah shqetësimin e ngritur nga ana e punonjësve të NjP, mbi mungesën e unifikimit që ka krijuar mospërputhje sa i përket kompetencave njohur punonjësve për të kryer hetime administrative, të parashikimeve të ligjit nr. 60/2016 (i ndryshuar) dhe atij nr. 114/2015 'Për auditimin e brendshëm në sektorin publik' (i ndryshuar).

Përgjatë periudhës objekt monitorimi, 2022-2023 në asnjë prej bashkive të monitoruara nuk është rregjistruar asnjë sinjalizim i brendshëm. Ndër arsyt kryesore që radhiten nga bashkëbisedimi me punonjës të NjP përmendim: mungesën e besimit të punonjësve për zgjidhjen e rastit nga NjP, mosnjohja në shkallë të gjerë e ligjit nr.60/2016, frika e punonjësve nga hakmarrja, si edhe frika e sinjalizuesve potencialë për identifikimin dhe mos garantimin e konfidencialitetit gjatë trajtimit të rastit.

NjP të monitoruara kanë hartuar Rregulloret e Brendshme për procedurat për shqyrtimin e rasteve të sinjalizimit dhe procedurat për trajtimin e kërkesave për mbrojtjen nga hakmarrja, por në pjesën më të madhe të tyre këto rregullore nuk janë publikuar në faqen zyrtare të bashkive. Gjithashtu, mungojnë në faqen zyrtare të bashkive të dhëna lidhur me anëtarët e NjP, rregullat proceduralë që duhen ndjekur për adresimin e një sinjalizimit, adresa e emailit të njësisë apo formularët tip të kërkesës të miratuar.

Në pothuajse pjesën më të madhe të NjP, nuk rezulton të jenë publikuar të dhënat për identifikimin e emrave të punonjësve të NjP. Përpos nevojës për garantimin e konfidencialitetit, KShH vlerëson se mos identifikimi krijon vështirësi në aksesin e punonjësve potencialë për të sinjalizuar raste të korrupsionit.

Në masë në të gjitha bashkitë e monitoruara, me përjashtim të Bashkisë Tiranë, nuk rezulton të jetë regjistruar asnjë rast sinjalizimi që nga ngritja e NjP. KShH e vlerëson të domosdoshme marrjen e masave nga ana e Bashkive për vendosjen në dispozicion të punonjësve një adresë të posaçme elektronike të dedikuar vetëm për raportimin e praktikave të dyshuara korruptive.

Anëtarët e NjP ndajnë qëndrimin se punonjësit kanë frikë nga hakmarrja, si dhe nga mosgarantimi i konfidencialitetit të sinjalizuesit nga ana e anëtarëve të NjP. Për të adresuar këtë sfidë, KShH vlerëson se anëtarët e NjP duhet të krijojnë infrastrukturën e duhur për ruajtjen e konfidencialitetit të sinjalizuesve potencialë në të gjitha fazat e procesit sipas parashikimeve të ligjit. Garantimi i adresimit të sinjalizimit anonim, vlerësojmë se duhet të mundësohet prej momentit të marrjes në dorëzim e administrim të sinjalizuesit nëpërmjet formave anonime, si dhe trajtimin e denoncimit në konfidencialitet të plotë nga pjesa tjetër e punonjësve, e aq më tepër funksionarit të sinjalizuar. Përdorimi i sistemeve teknologjike të zhvilluara që mundësojnë ruajtjen dhe analizimin e të

dhënave të sinjalizimit në format të enkriptuar, mendojmë se do t'i shërbejnë pozitivisht këtij procesi.

NjP pohojnë se nuk kanë autoritet të mjaftueshëm vendimmarrës për të monitoruar dhe ndjekur zbatimin e vendimeve të marra lidhur me rastet e sinjalizimeve. Procesi monitorues i ndërmarrë evidentoi mungesë të unifikimit të praktikës së kuorumit përbërës të anëtarëve të NjP. Me synim shmangien e problematikave, apo pengesave që mund të krijohen në rastet e mos konstituimit të NjP në vendimmarrje, si dhe garantimin e demokracisë vendimmarrëse, sugjerohet që çdo NjP të përbëhet minimalisht nga tre anëtarë. Në rastet e vakancave të krijuara në nivel të NjP, është e sugjerueshme që institucioni i vetëqeverisjes vendore të vërë në dijeni menjëherë ILDKPKI-në, e cila duhet të marrë masa të menjëhershme për të plotësuar vakancat e krijuara. Gjithashtu, çmohet e nevojshme forcimi i autoritetit vendimmarrës të NjP për të monitoruar dhe ndjekur zbatimin e vendimeve të marra lidhur me rastet e sinjalizimeve. Gjithashtu, rekomandohet që ILDKPKI-ja të monitorojë zbatimin e vendimeve që konfirmojnë ekzistencën e praktikave korruptive dhe të aplikojë sanksionet e parashikuara në nenin 23 të ligjit në rast të moszbatimit të tyre.

### **1.1 .Konteksti, qëllimi dhe kufizimet e monitorimit**

Ligji Nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, u miratua mbështetur në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2015-2017. Ky ligj ka pësuar amendime në vitin 2020<sup>2</sup>, duke shtrirë fushën e zbatimit të tij edhe mbi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Zbatimi i këtij ligji për pothuajse 8 vite ka nxjerrë në pah vështirësitë dhe sfidat me të cilat përballen NjP në kuadër të plotësimit të detyrimeve ligjore. KShH e çmon me rëndësi monitorimin e zbatimit të këtij ligji, si një mekanizëm kryesor në identifikimin dhe sinjalizimin e praktikave korruptive brenda institucioneve publike dhe entiteteve private. Për shkak të vëmendjes që KShH ka ndaj parandalimit dhe goditjes së korrupsionit në institucionet publike dhe private, ky ligj është monitoruar nga ana e KShH-së prej momentit fillestar të zbatimit të tij, e në vijimësi. Në këtë cikël të katërt të monitorimit nga KShH, janë mbajtur në konsideratë edhe problematikat dhe rekomandimet e sugjeruara nga KShH në raportet e mëhershme të monitorimit, të cilat kanë qenë objekt i vlerësimit nga ana e vëzhguesve të angazhuar.<sup>3</sup>

Në terma të përgjithshëm, qëllimi i ligjit është krijimi i një mekanizmi të ri denoncimi dhe goditjeje të veprimeve apo praktikave të dyshuara të korrupsionit në vendin e punës nga punonjësit e një

<sup>2</sup> Ligji Nr. 150/2020, datë 17.12.2020

<sup>3</sup> [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/03/3.3.21\\_Final\\_KORRUPSIONI2021\\_shqip.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/03/3.3.21_Final_KORRUPSIONI2021_shqip.pdf)  
[https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-Monitorimi\\_Sinjalizimi-i-korrupsionit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri\\_Sfidat-e-zbatimit-t%C3%AB-kuadrit-t%C3%AB-ri-ligjor.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-Monitorimi_Sinjalizimi-i-korrupsionit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri_Sfidat-e-zbatimit-t%C3%AB-kuadrit-t%C3%AB-ri-ligjor.pdf)  
[https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/06/Final\\_5-Qershor\\_Raport-i-ndermjetem-i-monitorimit\\_Sinjalizuesit.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/06/Final_5-Qershor_Raport-i-ndermjetem-i-monitorimit_Sinjalizuesit.pdf)

autoriteti publik apo subjekti privat, nëpërmjet mbrojtjes së individëve sinjalizues dhe nxitjes së sinjalizimit. Për këtë arsye, zbatimi në shkallë të gjerë i ligjit mbi sinjalizimin do të ndikonte në:

- a) **Parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit në veprimtarinë e institucioneve publike:** Sinjalizimi i praktikave të dyshuara korruptive do të ndihmonte në zbulimin e rasteve të korrupsionit që ndryshe mund të mos zbuloheshin. Kjo rrit efikasitetin e organeve të zbatimit të ligjit në identifikimin dhe hetimin e veprimeve korruptive.
- b) **Rritjen e transparencës:** Sinjalizimi i praktikave të dyshuara korruptive do të ndihmonte në rritjen e transparencës në institucionet publike. Ky proces krijon mundësinë që punonjësit dhe qytetarët të raportojnë në mënyrë anonime abuzimet dhe shkeljet e ligjit, duke kontribuar në një qeverisje më të mirë dhe më të përgjegjshme.
- c) **Mbrojtjen e interesave publike:** Nëpërmjet sinjalizimit të praktikave të dyshuara korruptive, mbrohen interesat e publikut nga veprimet e dëmshme që mund të kenë ndikim negativ në shërbimet publike dhe mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë.
- d) **Mbrojtjen e sinjalizuesve:** Njohja dhe zbatimi i ligjit nr. 60/2016 është e rëndësishme për të siguruar që sinjalizuesit të ndihen të sigurt të raportojnë shkeljet pa frikë nga hakmarrja, diskriminimi, ose ndëshkimi në vendin e punës. Një mbrojtje e tillë do të inkurajonte më shumë punonjës apo qytetarë për të ushtruar të drejtat që burojnë nga ligji, duke kontribuar në këtë mënyrë në luftën kundër korrupsionit.
- e) **Nxitjen e kulturës së etikës dhe përgjegjësisë:** Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve do të ndikonin në promovimin e një kulturë të etikës dhe përgjegjësisë në institucionet publike, ku punonjësit ndihen të përgjegjshëm për të raportuar dhe adresuar çdo sjellje të dyshimtë.
- f) **Përmirësimin e besimit publik:** Duke luftuar korrupsionin përmes sinjalizimit dhe duke mbrojtur sinjalizuesit, rritet besimi i publikut në integritetin dhe përgjegjësinë e institucioneve publike, që është thelbësore për funksionimin e demokracisë.

Bazuar në sa më sipër, vlen të theksojmë që në fillim të këtij raporti se sinjalizimi i praktikave të dyshuara korruptive dhe mbrojtja e sinjalizuesve janë elementë kyç në luftën kundër korrupsionit dhe në ndërtimin e një sistemi qeverisës më transparent, të përgjegjshëm dhe të besueshëm. Për këtë arsye, njohja e shkallës së zbatimit të ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” (i ndryshuar), si edhe evidentimi i sfidave me të cilat përballen njësitet përgjegjëse mbi sinjalizimin në nivel të qeverisjes vendore do të shërbenin jo vetëm në drejtim të ofrimit të një panorame të qartë lidhur me impaktin dhe nivelin e zbatueshmërisë së ligjit, por edhe për sa i përket arritjes së qëllimit për të cilin është hartuar ligji në terma të krijimit të një sistemi efikas dhe efektiv të luftimit të korrupsionit në institucionet e administratës publike në nivel vendor apo qendror.

Nëpërmjet këtij raporti, KShH synon:

- *Të vlerësojë gjendjen e zbatueshmërisë së ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” (i ndryshuar) në bashkitë objekt monitorimi;*



- Të eksplorojë nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimin institucional midis njësive përgjegjëse në nivel vendor dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;
- Të identifikojë sfidat dhe vështirësitë praktike në fushën e zbatimit të ligjit për sinjalizimin, si edhe çështjet prioritare që duhet të adresohen nga autoritetet në nivel vendor dhe autoriteti kompetent vendimmarrës në nivel qendror (ILDKPKI);
- Të krahasojë të dhënat e mbledhura dhe nivelin e zbatimit të ligjit në bashkitë e monitoruara, në raport me proceset e mëhershme monitoruese të ndërmarra nga KShH;
- Të adresojë rekomandime konkrete mbi rritjen e proaktivitetit të NJQV në drejtim të zbatimit të ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, forcimin e mekanizmit të denoncimit të praktikave korruptive në institucionet e qeverisjes vendore, si edhe garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të sinjalizuesve përfshirë garantimin e mbrojtjes kundër hakmarrjes dhe diskriminimit të tyre në vendin e punës.

Ky raport monitorimi dhe gjetjet e evidentuara në të, vlerësojmë se do t’i shërbejnë pozitivisht:

- Aktorëve institucionalë kompetentë për zbatimin e ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” (i ndryshuar);
- Organizatave jo-fitimprurëse në vendin tonë aktive në fushën e politikave kundër korrupsionit dhe forcimit të integritetit dhe demokracisë në institucionet publike;
- Organizatave rajonale/ndërkombëtare aktive që punojnë për të njëjtin qëllim, si edhe,
- Çdo pale interesi mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe statusin që sinjalizuesit duhet të gëzojnë në terma të zbatimit korrekt të ligjit.

## **2. Analiza e gjetjeve të monitorimit të zbatimit të ligjit mbi sinjalizimin në nivel vendor**

Misionet e monitorimit mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve u shtrinë në Bashkitë Durrës, Shkodër, Fier, Elbasan, Vlorë, Gjirokastër, Kukës, Korçë dhe Tiranë.

### **2.1 Përbërja dhe kapacitetet profesionale të Njesisë Përgjegjëse pranë Bashkive**

Njësitet përgjegjëse për mbrojtjen e sinjalizuesve ngrihen pranë autoriteteve publike në rast se ato kanë të punësuar më shumë se 80 persona, ndërkohë në subjektin privat ngritja e tyre bëhet e mundur kur rezultojnë më shumë se 100 të punësuar.<sup>4</sup> Ndërkohë që neni 3 pika 8 i ligjit nr. 60/2016 ka përcaktuar përbërjen e NjP nga një ose më shumë punonjës të entitetit, VKM nr. 816 dt. 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike”, ka përcaktuar në mënyrë eksplicite se struktura përgjegjëse përbëhet nga dy nëpunës/punonjës, përkatësisht nga drejtuesi i strukturës së auditimit të brendshëm dhe një nëpunës/punonjës i saj. Në ato raste kur autoriteti publik nuk ka në strukturën e tij strukturë auditimi të brendshëm, njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e

<sup>4</sup> Neni 10 pika 1 e ligjit nr. 60/2016

sinjalizuesve është drejtuesi i strukturës së burimeve njerëzore dhe një nëpunës/punonjës i saj.<sup>5</sup> Gjithashtu, në ato autoritete publike, në të cilat nuk kanë strukturë auditimi apo të burimeve njerëzore ose nuk plotësohet numri, sipas pikës 1) të këtij vendimi, njësia përgjegjëse plotësohet ose përbëhet nga dy nëpunës/punonjës të përhershëm të autoritetit, të cilët, duhet të kenë vjetërsi në punë jo më pak se dy vjet; të kenë mbaruar arsimin e lartë, i preferueshëm në shkencat juridike, shkencat sociale ose shkencat ekonomike, si dhe të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale. Ligji parashikon gjithashtu që anëtarët e Njesisë Përgjegjëse duhet të jenë të kenë marrë trajnim të posaçëm lidhur me sinjalizimin.<sup>6</sup>

Përgjithësisht në NjP të monitoruara, numri i personave përgjegjës pjesë e NjP ishte minimalisht 2. Vetëm në 2 nga 9 Njësitë e monitoruara, përkatësisht ato të ngritura pranë Bashkive Tiranë dhe Kukës, NjP përbëhej nga tre persona. Në përputhje me parashikimet ligjore të sipërpërmendura, punonjësit pjesë e NjP ishin me profil jurist ose ekonomik, dhe ishin përfaqësues ose të Drejtorisë së Auditit ose Burimeve Njerëzore pranë Bashkive respektive.

Duke mbajtur në konsideratë përbërjen e NjP në përgjithësi, KShH vlerëson se përbërja e anëtarësisë në numër çift, mund të krijojë problematika dhe vështirësi gjatë procesit të vendimmarrjes, duke mos i shërbyer objektivisht garantimit të parimit të demokracisë në vendimmarrje dhe duke prodhuar vendimmarrje unanime. Duke mbajtur në konsideratë përbërjen e anëtarësisë në numër tek të komisioneve apo ankesave funksionale pranë njësive të qeverisjes vendore, KShH vlerëson se duhet të rishikohet vendimmarrja e KM kundrejt garantimit të anëtarësisë prej 3 vetash të NjP.

Ndërkohë në Bashkinë Elbasan, edhe pse punonjësit fillimisht të emëruar si anëtarë të NjP kishin ndryshuar pozicionin e tyre të punës pranë Bashkisë (larguar nga Drejtoria e Auditit apo Burimeve Njerëzore), sërisht ata vazhdonin të mbeteshin anëtarë të NjP, duke mos u zëvendësuar nga nëpunësi përkatës pranë Drejtorive respektive.<sup>7</sup> Vlerësojmë se mungesa e zëvendësimit të tyre ndikon në mirë-funksionimin legjitim të NjP. Referuar pikës 9 të VKM nr 816/2016, në rastet e krijimit të vakancave, parashikohet informimi i menjëhershëm i ILDKPKI-së nga ana e titullarit të autoritetit publik. Ky i fundit është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme për zëvendësimin pa vonesa të nëpunësit/punonjësit të larguar të NjP me punonjës të strukturës përkatëse ose, sipas rastit, të strukturave të tjera.

Konkretisht, nga monitorimi u evidentua se në 4 nga 9 bashki nuk ka pasur asnjë ndryshim/zëvendësim të anëtarëve pranë NjP. Këto njësi janë ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë që prej vitit 2016 dhe vazhdojnë funksionimin e tyre me të njëjtën përbërje. Ndërkohë

---

<sup>5</sup> Pikat 2 dhe 3 të VKM nr. 816, dt. 16/11/2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike”

<sup>6</sup> Ibid, Neni 10.

<sup>7</sup> Në Bashkinë Elbasan, NjP vazhdon të përbëhej nga punonjës që ishin emëruar që në fillim në këtë pozicion, por që nuk ishin më në pozicionet drejtuese apo specialist të Drejtorive të Auditit dhe/ose Burimeve Njerëzore. Një nga anëtarët e NjP ishte larguar nga pozicioni i auditit prej më shumë se dy vitesh, por megjithatë vazhdon të mbetej i pa zëvendësuar si anëtar i NjP, edhe pse faktikisht nuk ushtronte asnjë funksion pranë kësaj Njësie.

në 5 bashkitë e tjera evidentohen raste të ndryshimit të përbërjes së NjP kryesisht për shkak të ndryshimit të pozicionit të punës të punonjësit të emëruar fillimisht si anëtar pranë NjP; daljes në pension të anëtarëve të NjP apo largimit të tyre nga detyra.<sup>8</sup>

Në Bashkinë Elbasan evidentohet si problematikë fakti se edhe pse të dy anëtarët e NjP ishin larguar nga pozicionet e punës që mbanin gjatë kohës kur ata ishin emëruar si anëtarë të NjP prej më shumë se dy vitesh, ende nuk ishte bërë zëvendësimi i tyre, duke pasqyruar funksionalitetin e kësaj Njësie vetëm me 1 anëtar. KShH vlerëson se kjo situatë shfaqet problematikë në raport me zbatueshmërinë e VKM nr. 816/2016. KShH nxit marrjen e masave konkrete nga ana e kryetarit të bashkisë për të zëvendësuar nëpunësin/punonjësën e larguar të njësisë përgjegjëse me punonjës të strukturës përkatëse ose, sipas rastit, të strukturave të tjera, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar në zbatim të ligjit nr. 60/2016.

Në rastet e punonjësve të zëvendësuar shtrohet nevoja e realizimit të trajnimeve të posaçme vazhduese e periodike mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Nën këtë synim, KShH e çmon me rëndësi luajtjen e një roli më proaktiv nga ILDKPKI për organizimin e sesioneve trajnuese e informuese të këtyre punonjësve, sipas një kalendari periodik e të mirë përcaktuar.

Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se autoritetet publike, që kanë degë territoriale në Republikën e Shqipërisë, krijojnë NjP vetëm në strukturën qendrore të tyre. Gjatë bashkëbisedimit me përfaqësuesit e NjP u vu në pah mungesa e qartësisë së tyre dhe konfuziteti lidhur me detyrimin ose jo që i ngarkohet për ngritjen e NjP edhe në nivel të institucioneve në varësi të bashkive. Si rrjedhojë, praktika e ndjekur nga ana e Bashkive rezultonte jo e unifikuar. Konkretisht, në 7 nga 9 bashki të monitoruara, NjP janë ngritur dhe funksionojnë vetëm në nivel bashkie duke mbuluar edhe trajtimin e rasteve që mund të sinjalizohen në nivel të institucioneve të tjera në varësi të Bashkive. Ndërkohë, vetëm në Bashkitë Tiranë dhe Durrës janë të ngritura përveç NjP në nivel qendror bashkie, edhe NjP në nivel të disa prej institucioneve të varësisë. Në këto 2 Bashki rezulton se NjP të ngritura pranë institucioneve të varësisë, nuk shkëmbejnë komunikim të drejtpërdrejtë apo raportues me NjP pranë Bashkisë në nivel qendror. Duke konsideruar mungesën e unifikimit të praktikës dhe problematikën e vështirësitë që krijohen në rastet e zbatimit të kuadrit ligjor në forma të ndryshe praktikishit, KShH e çmon të rëndësishëm rolin proaktiv dhe spjegues që duhet të luajë ILDKPKI-ja për informimin dhe qartësimin e NjP në nivel bashkie, me qëllim unifikimin e praktikës.

Në terma të kompetencave që punonjësit e NjP ushtrojnë, të gjithë anëtarët e NjP të intervistuar pranojnë njëzëri se funksioni i tyre si anëtar i NjP, vjen si një funksion i shtuar krahas pozicionit të tyre primar në institucion si punonjës pranë Drejtorive të Auditit apo Burimeve Njerëzore. Në këndvështrimin e projeksionit për të ardhmen, në momentin e përballjes me rastet e para të sinjalizimit, mbingarkesa e krijuar si rrjedhojë e kësaj mbivendosjeje të kompetencave, sipas punonjësve, mund të sjellë cedim në zhvillimin e kapaciteteve të tyre për të hetuar në mënyrë

---

<sup>8</sup> Raste të ndryshimit/zëvendësimit të anëtarëve të NjP evidentohen në Bashkitë Fier, Kukës, Durrës, Vlorë, Gjirokastrë.

gjithëpërfshirëse e brenda afateve të arsyeshme veprimet apo praktikat e dyshuara korruptive. Paralelisht, punonjësit pranë Bashkisë Shkodër ngrenë si shqetësim mospërputhjen ndërmjet ligjit nr. 60/2016 dhe atij nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorik publik” (i ndryshuar), sa i përket kryerjes së hetimeve administrative në rastet e sinjalizimeve.

Në kushtet kur NjP nuk është një strukturë e veçantë në organikën e bashkisë, vendimet e NjP konstatohet se hartohen nën logon e Drejtorisë së Auditit. Kjo situatë mund të krijojë paqartësi në drejtim të procedurave të kontrollit si audit, kundrejt atyre të hetimit si anëtarë të NjP. Lidhur me këtë, KShH rekomandon identifikimin e NjP në shkresat që hartohen nga kjo strukturë.

Në zbatim të ligjit nr. 60/2016 dhe akteve nënligjore për zbatim të tij rezulton se vetëm në 3 nga 9 NjP të monitoruara<sup>9</sup>, anëtarët e NjP pranojnë se kompetencat e tyre si anëtarë të NjP janë shtuar në përshkrimet e tyre të punës. Në 6 Njësiti e tjera<sup>10</sup>, anëtarët theksojnë mungesën e shtimit të detyrave si anëtar i NjP në përshkrimin e punës. Tërhoqi vëmendjen e vëzhguesve të KShH-së, perceptimi i shprehur nga anëtarët e njërës prej NjP të monitoruara të cilët e legjitimojnë mosreflektimin e kësaj detyre të rëndësishme në funksionin e tyre organik, me rëndësinë për mbrojtjen e anonimatit të tyre. KShH vlerëson se anëtarët e NjP, në kuadër të zbatimit të legjislacionit të posaçëm, duhet të marrin masa për garantimin e hapësirës dhe mjeteve të nevojshme për lehtësimin e aksesueshmërisë së punonjësve potencialë për të adresuar sinjalizime dhe për të kontribuar në luftën kundër korrupsionit. Kjo duhet të sigurohet nëpërmjet marrjes së masave për informimin e punonjësve të institucioneve për rolin e tyre, me anë të vendosjes së indikacioneve në zyrën që shërben si NjP, si dhe atashimin e këtij roli edhe në adresat elektronike zyrtare të anëtarëve të NjP.

Ndërkohë, vlen të theksojmë se edhe në rastet kur detyrat si anëtar i NjP janë shtuar në përshkrimet e punës të anëtarëve të NjP, në asnjërin prej tyre, këto detyra nuk ishin bërë pjesë e vlerësimit vjetor të performancës në punë të anëtarëve të Njësive. Në këtë kuptim, kryerja ose jo e detyrave si anëtar i NjP nuk passjell efekte lidhur me performancën në punë të punonjësve të emëruar pranë këtyre Njësive, gjë që mund të ndikojë edhe në cilësinë e ushtrimit të funksionit nga ana e tyre. Kjo vihet akoma më shumë në pikëpyetje, nëse marrim në konsideratë faktin se pavarësisht detyrave të shtuara për këta punonjës në zbatim të ligjit nr.60/2016, në asnjë rast, shtesa e funksionit nuk gjen reflektim në pagën që këta punonjës marrin pranë bashkive. Nisur nga sa më sipër, KShH rekomandon marrjen e masave nga ana e autoriteteve kompetente pranë Bashkive për të përditësuar përshkrimet e punës së punonjësve të emëruar pranë NjP duke shtuar detyrat e tyre si anëtarë pranë këtyre Njësive, si edhe përfshirjen e këtyre detyrave si pjesë të vlerësimit të performancës në punë të anëtarëve të NjP.

---

<sup>9</sup> Bashkia Tiranë, Kukës, Elbasan.

<sup>10</sup> Bashkia Durrës, Shkodër, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë dhe Fier.

## 2.2 Aksesueshmëria e Njërive Përgjegjëse pranë Bashkive dhe kanalet e sinjalizimit

Nga monitorimi në terren rezultoi se vetëm në 3 bashki<sup>11</sup>, NjP ishte lehtësisht e identifikueshme dhe aksesueshme për çdo punonjës/person të interesuar. Në 6 bashkitë e tjera<sup>12</sup> u vërejtën vështirësi si: vendosja e NjP jashtë ambjentëve të Bashkisë (psh: NjP pranë Bashkisë Tiranë); mungesa e vendosjes së emërimit dallues si NjP, duke e specifikuar vetëm si Drejtoria e Auditit (psh: NjP pranë Bashkive Korçë, Fier apo Durrës); mungesa e vendosjes së tabelave dhe simboleve identifikuese në ambientet e jashtme (psh: NjP pranë Bashkisë Vlorë apo Kukës), ose mungesa e një zyre të dedikuar për funksionimin si NjP (psh: NjP pranë Bashkisë Elbasan apo Durrës).

Duke synuar rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve të autoriteteve publike, dhe duke garantuar aksesueshmërinë e plotë të tyre tek NjP pranë Bashkisë, KShH sugjeron marrjen e masave konkrete nga ana e NjP për vendosjen e indikacioneve dalluese dhe identifikuese në zyrat respektive.

Pavarësisht se ligjvënësi ka parashikuar ndër kanalet e sinjalizimit, çdo mjet komunikimi që mund të përdoret nga sinjalizuesi potencial, përgjatë periudhës 2022-2023 asnjë sinjalizim i brendshëm nuk rezultoi të jetë adresuar pranë NjP të Bashkive objekt monitorimi. Vetë Bashkitë e monitoruara rezultoi se në mazhorancë nuk kanë ngritur kanalet e duhura që të garantojnë përcjelljen e sinjalizimeve edhe anonime. Më konkretisht në 5 prej Bashkive<sup>13</sup>, anëtarët e NjP pohuan se kanali i vetëm i komunikimit dhe përcjelljes së sinjalizimit është posta elektronike. KShH vlerëson se përdorimi i adresës zyrtare të Bashkisë për administrimin dhe përcjelljen e denoncimeve pranë NjP nuk është një mekanizëm efektiv dhe garantor i parimit të konfidencialitetit e paanshmërisë së procesit hetimor administrativ që ndërmerret. Sa i përket 4 NjP të tjera,<sup>14</sup> në të cilat sinjalizimi nuk mund të realizohet përmes postës elektronike, administrimi i rasteve të denoncuara realizohet nga zyra e protokollit. Për ndjekjen e kësaj procedure, në çdo rast nevojitet prezenca fizikisht e sinjalizuesit pranë NjP me qëllim regjistrimin e denoncimit. KShH vlerëson se kjo praktikë bie ndesh me parimin e konfidencialitetit dhe anonimatit. Këta faktorë, të ndikuar edhe nga frika nga hakmarrja mendojmë se ndikon në stepjen e punonjësve për të raportuar rastet. Sa më sipër, KShH çmon nevojën për marrjen e masave për administrimin e adresave të posaçme të sinjalizimit nga anëtarët e NjP, duke shmangur dyshimet dhe përceptimet për njohjen me sinjalizimin e adresuar nga pjesa tjetër e punonjësve.

Duke mbajtur në konsideratë vështirësitë dhe pengesat e verifikuara, e të adresuara edhe nga vetë punonjësit e NjP, KShH vlerëson se masa konkrete për ndërgjegjësimin e punonjësve të autoriteteve publike duhet të ndërmerren nga ana e ILDKPKI-së për të nxitur raportimin e rasteve të dyshuara korruptive nëpërmjet formës së sinjalizimit të jashtëm.

## 2.3 Miratimi i akteve nënligjore dhe transparenca

<sup>11</sup> Bashkia Shkodër, Gjirokastër dhe Vlorë.

<sup>12</sup> Bashkia Tiranë, Korçë, Kukës, Fier, Durrës dhe Elbasan.

<sup>13</sup> Bashkitë Tiranë, Shkodër, Gjirokastër, Vlorë dhe Elbasan.

<sup>14</sup> Bashkitë Korçë, Durrës, Fier dhe Kukës.

Në përgjithësi, NjP të monitoruara, kanë miratuar dhe kanë nën zbatim Rregullore të Brendshme për procedurën e shqyrtimit administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Megjithatë, konsiderohet problematike mospublikimi në masë i tyre në faqen zyrtare të bashkisë apo programin e transparencës. Në vetëm 3 prej bashkive të monitoruara, rregulloret janë të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë.<sup>15</sup>

Vetëm 3 prej institucioneve të monitoruara kanë publikuar në faqet zyrtare të tyre, kuadrin ligjor dhe atë nënligjor në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.<sup>16</sup> KShH nxit nevojën e publikimit në faqet zyrtare online të Bashkive, edhe të materialeve ndërgjegjësuese mbi zbatueshmërinë e ligjit nr. 60/2016 dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.<sup>17</sup> Ky format do t'i shërbejë informimit në masë edhe të ish-punonjësve, por edhe të publikut të gjerë. Më herët, KShH ka vënë në dispozicion të njëjësive të vetëqeverisjes vendore materiale online ndërgjegjësuese për këtë tematikë, të cilat i shërbejnë pozitivisht identifikimit dhe fuqizimit të rolit të NjP.

Konsiderohet një praktikë jo e mirëpritur në interes të garantimit të transparencës, fakti se në 6 Bashkitë e tjera të vendit,<sup>18</sup> jo vetëm që mungonte një seksion i dedikuar mbi sinjalizimin, por gjithashtu nuk ishin të publikuara as të dhënat e kontaktit të anëtarëve pjesë e NjP.

#### **2.4 Procedura e hetimit të rasteve të sinjalizimit dhe mbrojtja e të drejtave të sinjalizuesve**

Procedura e hetimit të rasteve të sinjalizimit dhe mbrojtja e të drejtave të sinjalizuesve rregullohet nga Kreu IV i ligjit nr.60/2016 dhe rregulloret e dala në zbatim të ligjit. Në zbatim të kuadrin ligjor, çdo sinjalizim duhet të regjistrohet në regjistrin e posaçëm. Së pari, vlerësohet nëse sinjalizimi është bërë sipas formës së kërkuar, ka në përmbajtje objektin e ligjit apo ka indicie për kundërvajtje administrative apo elementë të veprës penale, përndryshe me vendim të arsyetuar mund të gjykohej se mungojnë elementët e nevojshëm për fillimin e një procedure hetimi administrativ. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para ILDKPKI-së ose njësisë përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej tyre. Për të lehtësuar formën dhe përmbajtjen e sinjalizimit, ILDKPKI ka miratuar formularë tip për sinjalizimin e brendshëm, të jashtëm apo kërkesën për mbrojtjen nga hakmarrja me Urdhrin Nr. 1222, datë 11.7.2017 “*Për miratimin e formularëve dhe regjistrave të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve*”. Gjithashtu, ligji nr. 60/2016, i ndryshuar i jep sinjalizuesit të drejtën që të mbetet anonim duke arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe kur të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Ligji i garanton sinjalizuesit edhe mundësinë që të mos zbulojë burimet e informacionit, pra jo domosdoshmërisht ai duhet të ketë qenë në kontakt apo dijëni të drejtpërdrejtë të veprimit abuziv, por mund të sinjalizojë në mirëbesim edhe shkelle për të cilat është vënë në dijeni nga persona të tjerë. Një

<sup>15</sup> Tiranë, Elbasan, Korçë

<sup>16</sup> Bashkitë Elbasan, Gjirokastrë dhe Tiranë kishin një seksion të dedikuar për sinjalizimin si pjesë e faqes së tyre zyrtare.

<sup>17</sup> Vetëm në dy prej bashkive të monitoruara, e më konkretisht në faqet zyrtare të Bashkive Gjirokastrë dhe Durrës gjenden të publikuara materiale të kësaj natyre.

<sup>18</sup> Bashkitë Durrës, Fier, Shkodër, Korçë dhe Vlorë.

tjetër element që duhet theksuar është që sinjalizuesi gëzon të drejtën e mbrojtjes, sipas këtij ligji, deri në çastin kur sinjalizimi bëhet publik. Pra mund të thuhet që ky ligj ka qëllim edhe të shmangë rastet e sinjalizimeve publike të cilat mund të ndikojnë në imazhin e qytetarëve ndaj administratës publike.

Kur sinjalizimi ka bazë të mjaftueshme për të hetuar, fillon nga njësi përgjegjëse ose ILDKPKI procedurë e hetimit administrativ.<sup>19</sup> Është e rëndësishme që gjatë kësaj procedure vetë njësi përgjegjëse ose ILDKPKI të veprojmë me ndershmëri, paanshmëri, të pavarura politikisht etj., duke pasur parasysh interesat legjitim të sinjalizuesit, mbrojtjen e konfidencialitetit të tij dhe ruajtjen e sekretit shtetëror në përmbajtje të sinjalizimit, si dhe duke marrë të gjitha masat për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre.

ILDKPKI ka miratuar “*Rregulloren për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në ILDKPKI*”, e cila detajon procedurën që ndiqet për hetimin administrativ jo vetëm pranë saj, por që ka shërbyer si model edhe në kuadër të përmbushjes së detyrimit për hartimin e rregulloreve për hetimin administrativ dhe mbrojtjen e konfidencialitetit nga të gjitha njësitë përgjegjëse për sinjalizimin në autoritetet publike. Si rregull, çdo njësi përgjegjëse heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë ligj dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë periudhës së hetimit administrativ, njësi përgjegjëse shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Për këtë qëllim, ajo ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektive ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme. Nëse në përfundim të hetimit administrativ të sinjalizimit nga njësi përgjegjëse e një autoriteti publik ose ILDKPKI-ja rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja, sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent. Ndërkohë, që bazuar në nenin 14 të ligjit, NjP ka të drejtë të marrë vendim për mosfillimin ose përfundimin e hetimit administrativ në secilin prej rasteve të parashikuara në shkronjat a) – c) të nenit 14 të ligjit.

Si rregull, procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.<sup>20</sup> Në përfundim të hetimit, Njësia Përgjegjëse ka detyrim të hartojë vendimin për përfundimin e hetimit administrativ, të arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

Lidhur me procedurat e ndjekura nga NjP të monitoruara, u konstatua se në mungesë të rasteve të sinjalizimit, asnjëra prej tyre nuk kishte kryer një procedurë të hetimit administrativ për shkak të mungesës së sinjalizimeve të adresuara. Megjithatë, NjP ish-in të informuara lidhur me kërkesat

---

<sup>19</sup> Ibid, Neni 13, pika 1.

<sup>20</sup> Ibid, Neni 13, pika 2.

ligjore për sa i përket procedurës që do të duhet të ndiqej në situatën kur përpara tyre mund të paraqiteshin kërkesa për shqyrtimin e sinjalizimeve. Më herët, vetëm Bashkia Tiranë kishte pasur eksperiencë lidhur me shqyrtimin e kërkesave për sinjalizim. Megjithatë, edhe në këtë Bashki kishte paqartësi lidhur me shtrirjen e kompetencave vendimmarrëse nga ana e NjP në përfundim të hetimit administrativ. Sipas përfaqësuesve të NjP të kësaj bashkie, në përfundim të hetimit apo edhe nëse konstatohet ndonjëri prej rasteve kur duhet të mos fillohet hetimi, NjP nuk ka kompetencat për të marrë vendime. Ajo vetëm vë në dijeni titullarin e institucionit duke ia kaluar këtij të fundit kompetencën për marrjen e vendimeve, nënshkrimin e vulosjen e tyre. Edhe në rast të mosfillimit apo pushimit të proceseve të iniciuara nga sinjalizuesit, NjP pasi shqyrton rastin, i propozon titullarit të bashkisë marrjen e vendimit për mosfillimin apo pushimin e shqyrtimit të kërkesës. Duke mos pasur autoritet vendimmarrës, NjP nuk arrin të monitorojë apo ndjekë as marrjen e masave apo ekzekutimin e vendimit të nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë lidhur me një rast sinjalizimi. Kjo, siç pranohet edhe nga vetë anëtarët e NjP, mund të verë në pikëpyetje jo vetëm ekzekutimin e vendimeve në raste individuale, por sidomos mund të krijojë problematika lidhur me efikasitetin dhe impaktin që zbatimi i ligjit ka lidhur me marrjen e masave të menjëhershme për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar. Gjithashtu, nga ana tjetër një situatë e tillë vendimmarrëse krijon problematika në rastet e adresimit të sinjalizimeve ndaj vetë Kryetarit të autoritetit publik, i cili duhet të vendosë mbi propozimin e NjP. Njësia përgjegjëse, në pjesën më të madhe të rasteve, mund të përceptohet si e disponuar në kushtet e ndikimit dhe stepjes përballë autoritetit punëdhënës.

Mungesa e një mekanizmi kontrolli lidhur me ekzekutimin e vendimeve të titullarit të institucionit mbi rastet e sinjalizuara, ka rezultuar në vendime të pazbatuara nga ana e autoriteteve kompetente në nivel bashkie ose institucione varësie. Bazuar në sa më sipër, KShH rekomandon marrjen e masave për forcimin e autoritetit vendimmarrës të NjP në përputhje me parashikimet në ligjin nr.60/2016 (i ndryshuar). Në rast të moszbatimit të kompetencave ligjore, ILDKPKI-ja rekomandohet të aplikojë sanksionet e parashikuara në nenin 23 të ligjit nr.60/2016.

## **2.5 Ruajtja e konfidencialitetit të sinjalizuesve**

Ruajtja e konfidencialit është një e drejtë dhe parim bazë për mbrojtjen e të drejtave të sinjalizuesve. Kjo e drejtë garantohet nga neni 17 i ligjit për sinjalizimin dhe Udhëzimit Nr. 44, datë 31.08.2016 “Për kushtet, kriteret e përpunimit dhe kohën e mbajtjes së të dhënave personale” i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Konform parashikimeve të nenit 17/ 2 shkronjat a) dhe b), sinjalizuesi gëzon të drejtën e konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, si edhe ruajtjen e konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuesit. Lidhur me këtë, ligjvënësi parashikon gjithashtu në mënyrë taksative detyrimin e NjP për të marrë masa për mbrojtjen e të drejtave të sinjalizuesve sidomos lidhur me garantimin e konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, ruajtjen e konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuesit, si edhe marrjen e masave për mbrojtjen e tij kundër hakmarrjes.<sup>21</sup>

<sup>21</sup> Ibid, Neni 17.



Në referencë të zbatimit të kësaj dispozite, çmohet me rëndësi marrja e masave paraprake nga ana e NjP për të krijuar të gjitha garancitë për ruajtjen e konfidencialitet të sinjalizuesve potencialë. Të pyetur mbi masat e marra për garantimin e konfidencialitetit, anëtarët e NjP u shprehën skeptikë në mungesë të rasteve konkrete, duke pohuar gadishmërinë për të respektuar kërkesat ligjore në rast të kërkesave konkrete. Megjithatë, ajo që evidentohet si problematike, ishte fakti që anëtarët e NjP nuk arrinin të evidentonin asnjë masë të mundshme paraprake që mund të merrej me qëllim garantimin e konfidencialitetit të sinjalizuesve të mundshëm, si në drejtim të procedurave të regjistrimit të kërkesës, ashtu edhe procedurave të trajtimit të saj. Për sa më sipër, sugjerohet që ILDKPKI-ja të realizojë trajnime të dedikuara për të informuar dhe forcuar kapacitetet profesionale të punonjësve të NjP në drejtim të garantimit të konfidencialitetit të sinjalizuesve në të gjitha fazat e procesit sipas parashikimeve të ligjit nr. 60/2016 dhe Udhëzimit Nr. 44/2016.

## **2.6 Mungesa e rasteve të sinjalizimit dhe sfidat e Njësive Përgjegjëse**

Në vlerësimin e KShH-së, mungesa e rasteve të sinjalizimit vijon të ngrejë pikëpyetje lidhur me impaktin që ky ligj ka lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit në insitucionet publike në nivel qendror dhe vendor. Për më tepër, në mungesë të rasteve praktike, është e vështirë të arrihen konstatime lidhur me eficiencën e NjP, si edhe të artikulohej sfida dhe problematika konkrete të funksionimit të NjP. Anëtarët e NjP pranojnë se e kanë të vështirë identifikimin e sfidave konkrete me të cilat ata mund të përballen në rast të shqyrtimit të kërkesave të sinjalizimit. Megjithatë, edhe në këto kushte, disa nga problematikat e referuara nga ana e tyre që meritojnë vëmendje për t'u adresuar mbeten:

- Ngarkesa dhe dinamika e shtuar në punë për anëtarët e NjP krahas detyrave të tyre si punonjës në sektorin e auditit apo burimeve njerëzore: Lidhur me këtë sfidë, në nivel të NjP propozohet planifikimi i hapësirës për shtimin e një Koordinatori të posaçëm përgjegjës për Sinjalizimin në insitucionet publike apo krijimi i një Njësie të dedikuar për Korrupsionin dhe Sinjalizimin në nivel Bashkie.
- Mungesa e kapaciteteve profesionale dhe nevojës për trajnime: Lidhur me këtë sfidë, përfaqësuesit e NjP shtrojnë nevojën për shtimin e numrit të trajnimeve të dedikuara të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të NjP pranë Bashkive.
- Mungesa e mekanizmave të monitorimit të zbatimit të vendimeve të sinjalizimit: Mungesa e një mekanizmi monitorues të vënies në zbatim të vendimeve të dhëna në nivel të Bashkisë ngre problematikën e efikasitetit të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Edhe në rastet kur janë marrë vendime, nga anëtarët e NjP pohohet se edhe pas kalimit të një kohe relativisht të gjatë, ato ende nuk janë vënë në zbatim, gjë që mund të sjellë impakt negativ edhe në terma të besimit të punonjësve tek NjP dhe zbatimi i ligjit nga anëtarët.

## **2.7 Marrëdhënia e Njësive Përgjegjëse me ILDKPKI-në**

Nga bashkëbisedimi me përfaqësues të ILDKPKI-së dhe atyre të NjP objekt monitorimi, rezulton se bashkëpunimi është i frytshëm dhe reciprok. NjP pohojnë si formë kryesore komunikimi me ILDKPKI-në komunikimin shkresor në drejtim të kërkesave për informacion apo raportimeve

vjetore që këto Njësi hartojnë në fund të çdo viti. Nga monitorimi rezultoi se ILDKPKI-ja kishte ndërmarrë një mision kontrolli në të gjitha Njësitë e monitoruara në vitin 2021. NjP dokumentonin në dosje akt – kontrollin e ILDKPKI për vitin 2021, së bashku me gjetjet dhe detyrat e lëna nga kjo e fundit për secilën Njësi. Pjesa më e madhe e gjetjeve lidhej me detyrën për të hartuar dhe miratuar Rregulloret e brendshme në zbatim të ligjit për sinjalizimin, si edhe detyra dhe nevoja për informimin e punonjësve të bashkisë mbi kuadrin ligjor në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Me prioritet nga ana e NjP shtrohet shtimi i numrit të aktiviteteve trajnuese nga ILDKPKI-ja me qëllim rritjen e kapaciteteve të punonjësve të emëruar si pjesë e NjP, sidomos në rastet e Njësive të riorganizuara me punonjës të rinj.<sup>22</sup> KShH vlerëson rolin e ILDKPKI-së lidhur me këshillimin dhe orientimin e NjP për zgjidhjen e rasteve praktike.

## **2.8 Informimi i punonjësve mbi kuadrin ligjor për sinjalizimin**

Informimi i punonjësve të bashkive mbi kuadrin ligjor mbi sinjalizimin është mjaft i rëndësishëm në terma të rritjes së nivelit të informimit të tyre mbi mekanizmat ligjore për raportimin e praktikave të dyshuara korruptive brenda institucioneve të qeverisjes vendore. Gjatë intervistave të zhvilluara me anëtarët e NjP pranë bashkive rezultoi se NjP ishin kujdesur për të përcjellë informacionin mbi kuadrin ligjor në fuqi mbi sinjalizimin tek autoritetet drejtuese në nivel bashkie. Megjithatë, nuk evidentohet e njëjta situatë lidhur me institucionet e varësisë së Bashkive, ku punonjësit ishin pothuajse të painformuar mbi kuadrin ligjor dhe të drejtat e sinjalizuesve. Për më tepër, edhe vetë anëtarët e NjP, në mbi 80% të bashkive të monitoruara nuk ishin të informuar lidhur me Udhëzimin nr. 44/2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. KShH çmon të nevojshme rritjen e proaktivitetit të NjP lidhur me shtrirjen e informimit në masë të gjerë në drejtim të të gjithë punonjësve të administratës vendore lidhur me kuadrin ligjor në fuqi dhe garancitë mbrojtëse për sinjalizuesit në kuptim të ligjit nr.60/2016 (i ndryshuar).

## **2.9 Roli i ILDKPKI-së lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjit për sinjalizimin**

Në sajë të kompetencave të njohura ILDKPKI-së nga ana e ligjvënësit, nëpërmjet nenit 21 të ligjit nr. 60/2016 (i ndryshuar), vëzhguesit e KShH-së konstatuan se disa prej çështjeve të ngritura nga vetë përfaqësuesit e ILDKPKI-së vlen të ngrihen në nivel lokal dhe legjislativ:

*Së pari*, ILDKPKI-ja në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 60/2016 (i ndryshuar) ka kompetencën për të monitoruar zbatimin e ligjit në secilën prej Njësive Përgjegjëse. Monitorimi i zbatimit të ligjit dhe mekanizmi i kontrollit ushtrohet si përmes veprimtarive monitoruese në terren të ushtruara pranë NjP në Bashki, ashtu edhe përmes vlerësimit të raporteve vjetore që NjP dërgojnë çdo vit pranë ILDKPKI-së. Referuar aktiviteteve monitoruese, siç është konstatuar edhe më sipër, ILDKPKI ka monitoruar ngritjen dhe funksionimin e NjP të sinjalizimit në Bashki në vitin 2021. Në përfundim të tij, ILDKPKI ka hartuar planin e detyrave dhe rekomandimeve për çdo njësi të monitoruar. Nga sa konstatohet nga aktet e kontrollit të dokumentuara nga NjP në Bashki detyrat

---

<sup>22</sup> Në pothuajse të gjitha NjP të monitoruara pohohet se trajnimet e fundit të kryera nga ILKPKI-ja kanë qenë në vitet 2020-2021.

kryesore të ngarkuara nga ILDKPKI lidhen me: a) hartimin dhe miratimin e rregulloreve të brendshme mbi procedurat e shqyrtimit të sinjalizimit dhe mbrojtjes nga hakmarrja dhe b) rritjen e shkallës së informimit për punonjësit e bashkive lidhur me kuadrin ligjor dhe nënligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Gjithashtu, pjesë e rekomandimeve të ILDKPKI-së ka qenë edhe marrja e masave nga NjP pranë bashkive me qëllim forcimin e besimit të punonjësve në funksionimin e Njësive Përgjegjëse dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave të sinjalizuesve në raste konkrete.

**Së dyti**, referuar aktiviteteve trajnuese të ndërmarra nga ILDKPKI-ja bëhet e ditur se gjatë 2022, në bashkëpunim të ngushtë me ASPA-n dhe RAI (Iniciativa Rajonale kundër Korrupsionit), ILDKPKI-ja hartoi një kurrikul të posaçme trajnimi mbi sinjalizimin dhe një manual që adresonte pyetjet më të shpeshta që ishin ngritur nga punonjësit e NjP në të gjitha trajnimet e zhvilluara nga ILDKPKI-ja deri në 2022.

**Së treti**, referuar kanaleve të komunikimit me NjP, ILDKPKI pohon ekzistencën e një komunikimi formal me NjP pranë Bashkive. Ky komunikim lidhet me njoftimin e herëpashershëm që u bëhet NjP për t'i informuar mbi afatet, formën dhe mënyrën e raportimit vjetor pranë ILDKPKI-së. Komunikimet mbaheshin kryesisht përmes postës elektronike.

**Së katërti**, lidhur me mekanizimin e shqyrtimit të raporteve vjetore, në zbatim të nenit 22 pika 1 të ligjit, NjP i paraqet ILDKPKI-së çdo vit, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raport me shkrim për sinjalizimet e regjistruara, mënyrat e ndjekura për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Ajo çfarë vlen të nënvizohet është fakti se jo në të gjitha rastet, Bashkitë e respektonin afatin e dorëzimit të raporteve vjetore. Megjithatë, sipas ILDKPKI-së, në këtë rast nuk parashikohej asnjë masë ligjore që mund të merrej ndaj tyre për shkak të mosrespektimit të afateve. Neni 23 i ligjit, nuk parashikon vendosjen e masave administrative në rastet kur NjP nuk respektojnë afatet lidhur me hartimin dhe dërgimin e raportit të tyre vjetor. Bazuar në nenin 21 shkronja d) të ligjit, ILDKPKI-ja shqyrton raportet vjetore dhe ka kompetencë të japë rekomandime për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e NjP.

Gjithashtu, me rëndësi për t'u përmendur është mungesa e qartësisë në drejtim të autoritetit që ka detyrimin për të publikuar raportet vjetore. Nga monitorimi i kryer nga KShH, në asnjërin prej NjP të monitoruara, nuk publikoheshin në faqen zyrtare të Bashkisë raportet vjetore në zbatim të ligjit për sinjalizimin. ILDKPKI-ja pohon në këto raste se ligji nuk detajon rregullat mbi publikimin e raporteve vjetore të NjP të ngritura në nivel të institucioneve publike. Bazuar në nenin 22 pika 2 e ligjit, ILDKPKI-ja publikon çdo vit raport për zbatimin e këtij ligji, ku përfshihet numri i rasteve të sinjalizuara, rezultatet e rasteve, shkalla e ndërgjegjësimit dhe besimit të mekanizmat e sinjalizimit nga publiku, koha e përcaktuar për shqyrtimin e rasteve dhe zbatimin e mekanizmave të mbrojtjes nga hakmarrja. Mungesa e parashikimeve të qarta ligjore, ka rezultuar në një mungesë transparence lidhur me veprimtarinë e NjP për sa i përket zbatimit të ligjit nr.60/2016 prej tyre. Për sa më sipër, çmohet e nevojshme orientimi i NjP nga ana e ILDKPKI-së për të publikuar

raportet vjetore të veprimtarisë së tyre si pjesë e programit të transparencës, në interes të transparencës kundrejt publikut.

**Së pesti**, referuar funksionimit të ILDKPKI-së si mekanizëm që shqyrton sinjalizimet e jashtme, nga të dhënat e raportuara në raportin zyrtar të 2022 dhe informacionit të ofruar në rrugë shkresore nga ILDKPKI-ja rezulton se gjatë vitit 2022, ILDKPKI ka regjistruar dhe trajtuar 13 raste sinjalizimi dhe 2 kërkesa për mbrojtjen nga hakmarrja. Në analizim të rasteve të paraqitura, rezulton se kryesisht sinjalizimet janë paraqitur nëpërmjet postës elektronike, ku 12 raste sinjalizimi të jashtëm kanë ardhur nga sektori publik dhe 1 rast nga sektori privat. Megjithatë, mungojnë në raportin zyrtar të dhëna referuar kërkesave të shqyrtuara lidhur me bashkitë objekt monitorimi. Referuar sinjalizimeve anonime, ILDKPKI-ja gjatë vitit 2022, ka trajtuar 6 raste sinjalizimi të jashtëm të cilat janë regjistruar dhe trajtuar në përputhje me kërkesat ligjore. Nuk ka të dhëna referuar vendimarrjes lidhur me përfundimin e hetimeve për secilën prej këtyre raste.

Ndërkohë, gjatë periudhës Janar – Korrik 2023, ILDKPKI ka regjistruar dhe shqyrtuar 10 raste sinjalizimi dhe 1 kërkesë mbrojtje nga hakmarrja. Edhe në këtë rast, kanali i raportimit i përdorur nga sinjalizuesit ka qënë posta elektronike. Sipas informacionit të ofruar nga institucioni, sinjalizimet lidheshin kryesisht me parashtrimin e pretendimeve për “Shkelje ligjore në procedurat e tenderimit”, “Shkelje ligjore të procedurave të rekrutimit” apo “Shpërdorim detyre”. Për secilin prej rasteve të sinjalizuara, në përfundim të hetimeve administrative, Inspektorati ka vënë në dijeni organet kompetente, sipas problematikave të ngritura nga sinjalizuesit si vijon:

- Njoftim pranë Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit për marrjen e masave për inspektim në lidhje me institucionet në varësi të tij;
- Njoftim pranë KLSH për auditim të fondeve publike;
- Njoftim për ndjekje të mëtejshme, strukturave të Policisë së Shtetit;
- Njoftim për ndjekje të mëtejshme nga Autoriteti Publik Qendror.

Megjithatë, nuk referohen në raport të dhëna lidhur me vendimarrjen përfundimtare të ILDKPKI-së referuar rasteve të shqyrtuara nga ana e saj gjatë viteve objekt monitorimi. Gjithashtu nuk ka një ndarje të rasteve sipas llojit të institucioneve publike në nivel qendror apo vendor. Në këto kushte, nuk është e mundur ndarja e këtyre kërkesave sipas bashkive objekt monitorimi.

**Së gjashti**, nisur nga mungesa e qartësisë së NjP për sa i përket ngritjes ose jo të Njësive të veçanta në Institucionet e Varësisë së Bashkive apo numrit të anëtarëve në përbërje të NjP, KShH çmoi konsultimin e këtyre çështjeve me ILDKPKI-në. Referuar diskutimeve me përfaqësuesit e institucionit, ligji parashikon shprehimisht vetëm marrëdhënien midis zyrave rajonale dhe institucioneve qendrore. Si i tillë ai nuk parashikon detyrimin për të ngritur NjP edhe në institucione varësie. ILDKPKI mban qëndrimin se diskutime mund të ngriheshin vetëm në rastet e institucioneve të varësisë me më shumë se 80 punonjës. Megjithatë, edhe në këto raste ILDKPKI e konsideronte të mjaftueshme ngritjen e vetëm 1 Njësie Përgjegjëse në nivel të bashkisë. Referuar numrit të anëtarëve të NjP, ILDKPKI-ja nuk kishte evidentuar probleme në terma të

vendimmarrjes së NjP. Megjithatë kjo mund të ndikohet edhe nga mungesa e rasteve të trajtuara nga NjP.

*Së shtati*, lidhur me numrin e ulët të sinjalizimeve, edhe ILDKPKI ndan disa prej qëndrimeve të ngritura gjatë intervistimit të anëtarëve të NjP pranë Bashkive. Sipas përfaqësuesve të ILDKPKI-së, numri i kufizuar i rasteve lidhej kryesisht me a) mosbesimin ndaj strukturave të NjP-ve; b) frika nga hakmarrja për vendin e punës; si edhe c) adresimi i sinjalizimit drejtpërdrejtë tek institucioni epror dhe jo tek njësitë e varësisë.

*Së fundmi*, referuar kapaciteteve profesionale dhe logjistike të NjP, ILDKPKI vlerëson se nuk nevojitet krijimi i një strukture më vetë për sinjalizimin (sipas sugjerimeve të anëtarëve të NjP-së të intervistuar). Gjatë monitorimit që ata kishin kryer në NjP nuk ishin evidentuar vështirësi logjistike apo sfida lidhur me mungesën e kapaciteteve dhe/ose pamundësinë e punonjësve të NjP për të ushtruar funksionet sipas ligjit.

Përgjatë konsultimit të versionit draft të këtij Raporti, nga ana e përfaqësuesve të ILDKPKI-së nuk u adresuan komente apo sugjerime të tjera shtesë, duke vënë theksin në rëndësinë që sjell roli dhe kontributi i aktorëve të shoqërisë civile në monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe adresimin e rekomandimeve të qënësishme që i shërbejnë reformave dhe proceseve.

### 3.Rekomandime

#### 3.1 Rekomandime për Autoritetet Kompetente në Bashki

Bazuar në gjetjet e analizuara, KShH vlerëson ndarjen e disa rekomandimeve me aktorët përgjegjës, që mund t'i shërbejnë përmirësimit të nivelit praktik të zbatimit të kuadrit ligjor, KShH:

- Rekomandon marrjen e masave nga ana e autoriteteve përgjegjëse në Bashki për të venë menjëherë në dijeni ILDKPKI-në për vakancat e krijuara në nivel të NjP dhe për të plotësuar menjëherë vakancat e anëtarëve të NjP, konform nenit 9 të VKM Nr. 816, datë 16.11.2016.
- Duke konsideruar nevojën për rritjen e nivelit të informimit dhe aksesueshmërisë së punonjësve tek NjP pranë bashkive, KShH çmon të nevojshme informimin urgjent, të vazhdueshëm e periodik të punonjësve të bashkisë lidhur me ekzistencën e Njesisë Përgjegjëse dhe vendndodhjen e saj, si dhe ndarjen e materialeve ndërFgjegjësuese në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme në version elektronik.
- Rekomandon marrjen e masave për të publikuar rregulloret e brendshme të hartuara në përputhje me ligjin nr.60/2016 në faqen zyrtare të bashkisë dhe për të krijuar nën programin e transparencës, të një seksioni të dedikuar për sinjalizimin i cili të përmbajë të dhëna lidhur me: kontaktet e anëtarëve të NjP, aktet ligjore dhe nënligjore mbi sinjalizimin, rregulloret e miratuara në nivel bashkie, formularët tip që mund të përdoren nga sinjalizuesit potencialë, si edhe materiale të tjera ndërFgjegjësuese në shërbim të rritjes së informimit të punonjësve.

- Rekomandon marrjen e masave proaktive nga ana e NjP për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin e punonjësve mbi përmbajtjen e ligjit dhe garancitë ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve përballë akteve hakmarrëse.

### **3.2 Rekomandime për Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit**

- Rekomandon marrjen e masave për të forcuar kapacitetet profesionale të punonjësve të NjP duke garantuar trajnimin e vazhdueshëm të tyre në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. Ky rekomandim vjen sidomos i lidhur me rastet e riorganizimit të NjP, punonjësit e të cilave janë zëvendësuar me nëpunës të rinj.
- E çmon të domosdoshme udhëzimin e NjP për të unifikuar zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore nga NjP lidhur me përbërjen e NjP (numrin e anëtarëve), publikimin e raporteve vjetore të NjP apo përmbajtjen e të dhënave të analizuara në raportimet vjetore. Lidhur me këtë rekomandim, shihet me interes hartimi i një formati tip raportimi për t'u mbajtur në konsideratë dhe ndjekur nga të gjitha NjP.
- Referuar raportit vjetor që ILDKPKI-së prezanton përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, KShH vlerëson të nevojshme që përmbajtja e tij në lidhje me zbatimin e ligjit mbi sinjalizimet të jetë më gjithëpërfshirëse dhe e detajuar, duke mos u kufizuar vetëm në reflektimin e të dhënave sasiore, por duke analizuar në mënyrë më të detajuar objektin dhe natyrën e vendimarrjes në rastet e pranuar ose jo.

### **Bibliografia:**

- Ligji nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”
- Rregullores<sup>[L]</sup><sub>[SEP]</sub> për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e Konfidencialitetit – miratuar nga I.L.D.K.P.K.I
- Rregullore për Hetimin Administrativ të Kërkesës së Sinjalizuesit për Mbrojtjen nga Hakmarrja- miratuar nga I.L.D.K.P.K.
- Udhëzim Nr. 1, Datë 23.9.2016 “Për Miratimin /Përcaktimin E Strukturës, Kriteret E Përzgjedhjes Dhe Trajnimin E Punonjësve Të Njesisë Përgjegjëse Në Subjektet Private”
- Udhëzim Nr. 44, Datë 31.08.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtës për Informim dhe të Dhënave Personale “Për Kushtet, Kriteret e Përpunimit dhe Kohën e Mbajtjes së të Dhënave Personale”
- Vendim Nr. 816, Datë 16.11.2016 “ Për Strukturën, Kriteret e Përzgjedhjes dhe Marrëdhëniet e Punës së Punonjësve të Njesisë Përgjegjëse në Autoritetet Publike, në Zbatim të Ligjit Nr. 60/2016, “Për Sinjalizimin Dhe Mbrojtjen E Sinjalizuesve”